



Publikim per Thirrje per projekt Propozime

Shpallet Thirrja e I-rë për projekt propozime e Programit IPA CBC Shqipëri - Kosove

Referenca e Publikimit EuropeAid /133224/M/ACT/AL

Në kuadër të Programit IPA Bashkëpunimi Ndërkufitar (CBC) ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Kosovës 2010-2013, që do të zbatohet në Republikën e Shqipërisë në rajonet e lejueshme: Prefekturën Kukës, dhe në zonat shtese të programit, Prefekturën Shkodër dhe Dibër; për Rajonin Kosovë, në dy rajonet e lejueshme të Programit përkatësisht Rajoni Ekonomik Jugor dhe Rajoni Ekonomik Perëndimor i Kosovës, shpallet Thirrja e I-rë për Projekt propozime për të zbatuar skema granti në sektorin e Zhvillimit Ekonomik, Mjedisor, Kulturor dhe Social.

Objektivat e programit do të arrihen duke zbatuar masat e mëposhtme:

Masa 1.1: Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor

Masa 1.2: Kohezioni social dhe shkëmbimet kulturore përmes aktiviteteve që afrojnë njerëzit dhe institucionet

Masa 2.1 – Administrimi, monitorimi dhe vlerësimi i Programit

Masa 2.2 - Informimi dhe Publiciteti për Programin

Përfituesit e lejueshëm që mund të aplikojnë:

Administrata të pushtetit vendor (rajone, rrethe, bashki dhe komuna); Shoqata profesionale; Dhomat e Tregtisë dhe organizata të tjera që mbështesin biznesin; Agjenci / institucione jofitimprurëse kombëtare dhe vendore; Organizata publike të qeverisjes qendrore ose vendore; Zyrtarë vendore të punësimit; Universitetet, shkollat, institucionet arsimore dhe kërkimore; Qendrat e formimit profesional; Parqet kombëtare; Shoqatat kulturore dhe sportive; OJF-të;

Ku dhe si duhet të dërgohen Aplikimet

Aplikimet duhet të dorëzohen në dy origjinale dhe dy kopje me format A4, secila. Pjesa A: Format i plotë i aplikimit (format i permisuar në excel); pjesa B: formati i plotë i buxhetit dhe pjesa C është korniza e kuadrit logjik - duhet gjithashtu të jenë në formatin elektronik (CD) – por në një format i cili lejon modifikime për qëllime kontraktimi. Formatin elektronik duhet të përmbajë ekzaktësisht të njëjtin aplikim si në versionin në letër. Checklist-a, Deklarata nga Aplikantët, Marrëveshja e Partneritetit dhe Deklarimet e Partneritetit mund të kapen më vete dhe të shtohen në zarf.

Zarfi i jashtëm duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- Numrin e referencës së publikimit të thirrjeve për propozime;
- Titullin e Projekt Propozimit;





- Numrin dhe titullin e komponentit (Numri dhe titulli i Masës)
- Emrin dhe adresën e plotë të Lead Partnerit;
- Fjalët "Not to be opened before the opening session" dhe në Republikën e Shqipërisë dhe të Kosovës "Të mos hapet përpara sesionit të hapjes së aplikimeve"

Aplikimet duhet të dorëzohen në një zarf të vulosur nga një postë e regjistruar, korier privat, ose dorazi (shoqëruar me një faturë të firmosur dhe me datë), në adresën e mëposhtme:

Joint Technical Secretariat (JTS)-Kukes

Hotel " Gjallica " 2nd floor Kukes , Shqiperi

Afati përfundimtar për dorëzimin aplikimeve eshte data 25 Shtator 2012, ora 16.30

Dokumentet perkatese dhe udhezimet do ti gjeni ne linket e meposhteme:

<http://www.mie.gov.al/> MIE – Ministri e Integrimit ne Tirana

<http://www.mapl.rks-gov.net> MLGA – Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal

<http://www.cbckosovo.eu> CBC Kosovo

http://www.eeas.europa.eu/delegations/kosovo/index_en.htm - Zyra e Bashkimit European ne Kosove

http://ec.europa.eu/delegations/albania/index_en.htm - Delegacioni I Bashkimit European ne Tirana

2 sesione informuese do te mbahen ne Prizren (Kosove) and Kukes (Shqiperi) respektivisht ne datat 23 Korrik 2012 dhe 30 Korrik 2012, ora 9.00 hrs. Informacion te metejshe per vendin dhe agenda ju do ti gjeni ne faqet web te MIE – Ministri e Integrimit ne Tirane & MLGA – Ministria e Administrimit dhe Pushtetit Lokal ne Kosove

** This designation is without prejudice to positions on status, and is in line with UNSCR 1244 and the ICJ Opinion on the Kosovo Declaration of Independence*

